REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr/Ko 01-060/01-0052174/24
Data/Datum 13.11.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

**Kuvendi i Komunës**/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 52, par.1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe nenit 12, par.1,2,3,4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve te përhershme në Komunë, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

# THËRRET

**Mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa**, që mbahet me datën **19.11.2024** (ditë e marte), me fillim prej orës **10:00**, në Sallën e Bordit të Drejtorëve.

**Mbledhja do të ketë këtë:**
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton drejtori i DUMA-së, **z. Driton Mulaj**);
5. Të ndryshme.

**KRYESUESJA E KUVENDIT**
znj. Adelina Spahiu

**Kuvendi i Komunës**/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë **22.10.2024**, në ora **11:00**, në sallën e bordit të drejtoreve.

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, me Nr.09-325/04-0048367/24, i datës 11.10.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
6. Të ndryshme.

**Kryesuesja:** Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në ketë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së, mungon me arsye Alketa Mecini.
Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës së bashku me 5 pikat shtesë .
Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:
Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:
-Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024, (Raporton);
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Fjala përshëndetëse, raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, është një dokument i hartuar për periudhën kaluese 9 mujore sipas ligjit, të hyrat komunale të realizimit deri në shtator janë alokuar sipas planit buxhetor, dhe gjitha mjetet e pa shpenzuara në tre mujorin paraprak janë bartur në tre mujorin e fundit, me vendime gjyqësore përmbarimorë në emër të shujtave inflacionit dhe licencimit të bazuara në kontratën kolektive për mësimdhënës të arsimit para universitare janë paguar përmes thesarit në shume 2,208,473.72€, ndryshim tjerë në të hyra buxhetore ka pas grandi i përformancesë prej 603,119.51€. të hyrat vetanake nga viti aktual kanë shënuar përqindje të realizimit në 93.85% dhe jemi afër përmbushjes së planit për këtë vite. Buxheti është shpenzuar në 83.51%, në faqen 6 i kemi gjitha llojet e të hyrave, dhe llojet e shpenzimeve, në faqen 7 i kemi projektet kapitale, kush ka pyetje jam këtu për çdo përgjigje.
**Kryesuesja:** E hap debatin, fjalën ja kaloj:
**Mentor Mehmeti-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor i pash vendimet përmbarimore, tani po vjen muaj nëntor dhe dhjetor për punëtoret e arsimit sa janë gjasat që këta me mbete pa paga, a ka ndonjë forme të kompensimit apo kanë me mbet pa paga si disa komunat tjera?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Kjo është një sfidë që ka ndodhur për herë të parë në buxhetin aktual të komunave, për kontratat kolektive nuk ka qenë e planifikuar një shpenzim i paparashikuar si do të sjelle vështirësi në arsim, këtë telash e kanë edhe një 10-15 komuna tjera në nivel vendi. Ne e kemi bë një fond shtesë për kompozim që kemi drejtë ligjore dhe nuk kemi marr as një përgjigje së përveç pagave na kanë marr edhe neper kategori tjera, si në mallra dhe shërbime, projekte kapitale, jemi tu e pritë një përgjigje prej tyre dhe do të jetë një vite sfidues, po presim mos po e bëjnë ndonjë rishikim t buxhetit që e kanë atë drejtë.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Ilir Ejupi-IDEAL:** Edhe unë e pata në planë me ngrit ketë çështjen e Mentorit, mirëpo desha me u ndërlidh që the është e paplanifikuar dhe ka ndodhur rastësisht, dhe unë nuk mendoj që u kanë e paplanifikuar që ka me na ardhur ky problem, sepse vitin e kaluar dhe vitet tjera mësimdhënësit përmes përmbarimit i kanë marr mjetet për shujta edhe për këtë vite e kana ditë ketë situatë, edhe para dy viteve ka qenë premtim përmes mjeteve të informimit së gjeja i këna sigurua çështjen e shujtave për mësimdhënës. Dhe kish me qenë mirë që vitin e kaluar me parashikuar këtë problem, ose me nda mjete shtesë e jo me ardhur deri tek problemi i mungesave të pagave.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Ilir ke drejtë, që thua me planifikua mjete për këtë çështje, po ministria e financave i banë këto kalkulime me paga aktuale që e parasheh një rritje prej 4-5% mbi pagat e rregullta nuk lenë me planifikua asgjë me shume, dhe nuk i ka marr parasysh këto shpenzime këto shqetësime sepse e kemi ngritë çdo herë.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Mentor Mehmeti-PDK:** Drejtor a nuk qëndron një kodë i veçantë për kontratat përmbarimore në komunë, dhe a është bërë ndonjëherë ndonjë kërkesë e tillë që me ekzistua aj kod për raste të tilla?
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Mentor, është e drejt e komunës me pas rezerva buxhetore që deri me tani nuk është lejuar të kemi rezerva buxhetore me i pas për detyrime kontingjente që kështu thirren, për ketë vite nuk është lejuar, për vitin tjerë na është lejuar me pas rezerva buxhetore, po ne e kemi aprovuar buxhetin e rregullt, po mendojmë që deri në fund të vitit po përmbyllet ky proces që ka ndikim ma se shumti buxhetor, po na ka sjell telashe për vitin aktual së mbi 1.500.000.00€ janë marrë paga, dhe 2.200.000.00€ janë marrë krejt.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Ilir Ejupi-IDEAL:** Drejtor përse veç në arsim parashihet me pas mungesë pagash, pasi që përmbaruesi nuk pyet së ku mi marrë, apo ka marrëveshje së ku me i marr paret?
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Tash punëtorët e arsimit janë të gjithë, dhe kur na vinë vendimet gjyqësorë prej thesarit, e bëjnë ekzekutimin e tyre, dhe duhet me dhënë një konfirmim prej me i ekzekutua, dhe nëse nuk japim konfirmim, na i marrin aty ku është krijuar obligimi dhe obligimi është krijuar të mësimdhënësi, dhe deri me tani nuk janë prekur paret e administratës komunal, po tash i kanë lanë edhe ato së nuk kanë drejtë deri mbi 5% të fondeve totale me i marr, janë kthye po i marrin neper projekte kapitale dhe neper kategori tjera, me krijua obligime të administrata i marrin edhe aty, po nëse vinë prape vendime tjera mujnë marrë edhe të administrata d.m.th nuk të vetë.
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (12) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:
-Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, me Nr.09-325/04-0048367/24, i datës 11.10.2024, (Raporton);
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, që ka konstatuar döme në bujqësi 51 raste, në ekonomi familjare 4 raste, në vlerë të përgjithshme 279.123.03€, materialin e keni para veti, me listën e personave të dëmtuar, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024.
Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:
Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, fjalën ja kaloj
**Mentor Mehmeti-PDK:** Për drejtorin e bujqësisë, po nuk koka këtu, desha me i ngrit një problem me qenet endacak e kemi një shqetësim shume të madh, që një ditë mu ka flugë mua personalisht, po edhe nxënësit po kanë ankesa prej tyre që po janë të rrezikuar, që është një numër shume i madh në qytetin, nuk e di ka po vinë?
**Ilir Ejupi-IDEAL:** E kam një pyetje për drejtorin e arsimit, Kulmi i shkollës në Qirezë është ndërruar, pyetja ime është çka ka ndodhur me kulmin e vjetër, së ka shqetësime brenda shkollës që gjeja është keqpërdorur nga personat jashtë shkollës dhe është marr nga individët e caktuar, dhe në atë shkollë nuk punon fotokopja?
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku**: Fjala përshëndetëse, Ilir, kulmi i shkollës është ndërrua që një kohe të shkurtë, e di që komisioni e ka bë vlerësimin që aj kulm që është ndërrua është jashtë përdorimit dhe ka e kanë orientuar nuk e di dhe mujë e marrë një përgjigje nga drejtori dhe tregoj, sa i përket fotokopjes, e kemi një kontratë që e furnizon gjitha shkollat me fotokopje dhe toner, dhe se shpejti ka me bë zgjidhjen..
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë 30.10.2024, në ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 06-351/01-0052104/24
Data.
Data. 13. 11. 2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit**
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambienta
Department of Urban and Environmental Proctection

## Informatë për Lejet ndërtimore për vitin 2024

| Nr. | Pronari | Lloji i lejes | Nr.protokollit | Data | Shuma totale € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Isuf Aliqkaj | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0010204/24 | 21.02.2024 | 8,413.56 |
| 2 | Rreze Company shpk | Hangar-depo | 06-351/02-0011036/24 | 28.02.2024 | 2,902.59 |
| 3 | Beli Invest shpk | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0010852/24 | 29.02.2024 | 8,245.45 |
| 4 | EL Tech Kosova | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0010385/24 | 04.03.2024 | 18,549.79 |
| 5 | Andrra Invest LLC - 1 | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0013066/24 | 20.03.2024 | 12,544.68 |
| 6 | Fidaim Shala | Objekt banimi | 06-351/02-0056077/24 | 22.03.2024 | 8,963.09 |
| 7 | Autolarje Meti shpk | Autolarje-Leje e përkohshme | 06-350/02-0015158/24 | 27.03.2024 | 369.71 |
| 8 | Omer & Nili Invest Sha | Stacioni me objekte përcjellese | 06-351/02-0014756/24 | 04.04.2024 | 11,942.90 |
| 9 | DSHP | Subqendra Likovc | 06-351/02-0017831/24 | 15.04.2024 | |
| 10 | DSHP | Subqendra Runik | 06-351/02-0017823/24 | 15.04.2024 | |
| 11 | DSHP | Subqendra Qirez | 06-351/02-0017832/24 | 15.04.2024 | |
| 12 | Perparim Kadriu | Banim | 06-351/02-0014730/24 | 14.05.2024 | 1,719.44 |
| 13 | Asons Invest shpk - 2 | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0014528/24 | 20.05.2024 | 23,444.47 |
| 14 | NewVision Arbl shpk | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-001957624 | 24.05.2024 | 8,967.84 |
| 15 | ANB & KS- L/02 | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0017175/24 | 03.06.2024 | 23,754.19 |
| 16 | Arif Mala | Shtepi banimi | 06-351/02-0023830/24 | 19.06.2024 | 745.89 |
| 17 | Kabashi Invest | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-000688/24 | 21.06.2024 | 15,572.73 |
| 18 | Xani Dekor shpk | Banim | 06-351/02-0026494/24 | 08.07.2024 | 1,039.47 |
| 19 | Isa shpk PH-Lamella A | Banim | 06-351/02-0023367/24 | 11.07.2024 | 2,440.88 |
| 20 | Isa shpk PH-Lamella C | Banim | 06-351/02-0023365/24 | 11.07.2024 | 1,409.32 |
| 21 | Valon Spahiu | Fabrikë për prodhimin e gelqerës | 06-351/02-0028323/24 | 11.07.2024 | |
| 22 | Vllazërit Osmani shpk | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0028859/24 | 12.07.2024 | 10,310.64 |
| 23 | Ismet Commerc PH | Banim | 06-351/02-0023357/24 | 15.07.2024 | 2,576.04 |
| 24 | Xani Partners shpk | Plotesim-ndryshim | 06-351/02-0026490/24 | 17.07.2024 | 184.39 |
| 25 | Mehdi Gjoka BI | Pompë e derivateve e lokal afarist | 06-351/02-0031679/24 | 17.07.2024 | 5,118.75 |
| 26 | Halim Kuliqi | Shtepi malore | 06-351/02-0028625/24 | 22.07.2024 | 342.85 |
| 27 | AHB Group | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0015724/24 | 23.07.2024 | 21,427.33 |
| 28 | Babaj Project | Banim | 06-351/02-0027651/24 | 24.07.2024 | 2,269.71 |
| 29 | DSHP | Qendra e Zjarrfikesve | 06-351/02-0033026/24 | 25.07.2024 | |
| 30 | ANB & KS- L/05 | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0029164/24 | 29.07.2024 | 26,489.39 |
| 31 | Azem Bejta | Fabrikë e dyerve e dritareve | 06-351/02-0031553/24 | 30.07.2024 | |
| 32 | Mimozë Demaku | Depo pë ruajtje të pemëve | 06-351/02-0037003/24 | 12.08.2024 | 168.00 |
| 33 | QMF | Qendra e mjekesisë familjare | 06-351/02-0037609/24 | 12.08.2024 | |
| 34 | Drena shpk | Kat shtesë në Objekt afarist | 06-351/02-0045768/24 | 27.09.2024 | 3,641.88 |
| 35 | Syla Group | Aneks | 06-351/02-0046674/24 | 02.10.2024 | 559.99 |
| 36 | AT & N Group shpk | Objekt afarist-banesor | 06-351/02-0048933/24 | 24.10.2024 | 55,164.67 |
| | | | | TOTALI | € 279,279.64 |

Skenderaj,me 13.11.2024
1.Arkivit
2.Zyrës se kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT

Drejtori:
Driton Mulaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 06-351/01-0052097/24
Data
Data 13 11 2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit**
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambienta
Department of Urban and Environmental Proctection

Në bazë të nenit 17 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040/2008, Në bazë të nenit 6, 7, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje (Gazeta Zyrtare Nr. 14, 20.Gusht 2018), Ligji nr. 08/L-184 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-024 ( Gazeta Zyrtare Nr.20/16 Gusht 2023) si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ Nr.06/2019, neni 63 pika b të statutit të Komunës së Skenderajt Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit si organ profesional, e Informon Kuvendin e Komunës:

**INFORMATË PËR PROCESIN E LEGALIZIMIT**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në procesin e Legalizimit për vitin 2024 që nga 01.01.2024 e deri me datën 14.11. 2024, ka pranuar këto kërkesa:

**Total janë 18 kërkesa për Çertifikatë të Legalizimi, prej tyre :**

1. **14 lëndë janë paisur me Çertifikatë të Legalizimit dhe kan kaluar në Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë - të përfunduara**
2. **32 lëndë të cilat janë në pronë shoqërore, mbesin në listën e pritjes deri në një vendim nga MMPHI**

| **LËNDË TË PËRFUNDUARA** | **LËNDË NË PROCES** | **LËNDË NË PRITJE Qe nga fillimi i procesit të legalizimit.** |
|---|---|---|
| S+P+2+Nk - 1 lëndë | 3 lëndë 2024 | P+0 – 5 lëndë |
| B+P+Nk – 1 lëndë | | P+2 – 7 lëndë |
| P+1+NK – 1lëndë | | B+P+1 – 2 lëndë |
| P+1- 5 lëndë | | B+P+2 – 1 lëndë |
| P+0 -1 lënd | | B+P+4 – 3 lëndë |
| P+3 – 1 lënd | | B+P+NK – 1 lëndë |
| S+P+2-1 lënd | | S+P+1 – 4 lëndë |
| P+4+Ph -1lënd | | Pa etazhitet – 9 lëndë |
| P+2+Ph -1 lënd | | |
| P+3+Ph- 1lënd | | |

Të gjitha lëndet e lartëcekura janë plotësur sipas Ligji nr. 08/L-184 Për Ndryshimin dhe Plotësimin të ligjit të legalizimit 06/L-024 .

Datë: 13.11.2024

1.x. Arkivit
1.x. Kryesueses se K.K
1.x. Kryetarit të Komunës
Skenderaj 2024

Drejtori:
idn. Driton Mulaj

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 06-350/01-0058098/24
Data 13 11 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambienta
Department of Urban and Environmental Proctection

Lista e Lejeve Mjedisore Komunale per Komunen e Skenderajt viti 2024

| Nr. | Pronari | Lloji I lejes | | uniref | Shuma e paguar € | Borgjet | Shuma totale € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | EL TECH Kosova | Leje Mjedisore Komu | 26.02.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2,246.55 € |
| 2 | Beli Invest SH.P. | Leje Mjedisore Komu | 28.02.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 913 € |
| 3 | ANDRRA INVES | Leje Mjedisore Komu | 20.03.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2412,72 |
| 4 | OMER& NILI IN | Leje Mjedisore Komu | 28.03.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2,380.08 |
| 5 | ANDRRA INVES | Leje Mjedisore Komu | 20.05.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 6,735.90 |
| 6 | KABASHI INVE | Leje Mjedisore Komu | 21.06.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2,581.23 |
| 7 | ARIF LUSHTAK | Leje Mjedisore Komu | 23.05.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 995.96 |
| 8 | ANB & KS | Leje Mjedisore Komu | 14.05.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2,353.71 |
| 9 | Perparim Kadriu | Leje Mjedisore Komu | 08.05.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 302.93 |
| 10 | Isuf Aliqkaj | Leje Mjedisore Komu | 20.02.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 1,209.53 |
| 11 | AHB Group SH.P | Leje Mjedisore Komu | 25.03.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 4,001.14 |
| 12 | ANB & KS | Leje Mjedisore Komu | 29.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 2,110.98 |
| 13 | Valoni Spahiu | Leje Mjedisore Komu | 11.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | e liruar |
| 14 | ISA SH.P.K. | Leje Mjedisore Komu | 11.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 112.13 |
| 15 | ISA SH.P.K. | Leje Mjedisore Komu | 11.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 171.95 |
| 16 | XANI DEKOR | Leje Mjedisore Komu | 12.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 54.43 |
| 17 | VLLAZERIT OS | Leje Mjedisore Komu | 12.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 1,103.03 |
| 18 | ISMET I. MUST | Leje Mjedisore Komu | 15.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 204.08 |
| 19 | MEHDI GJOKA | Leje Mjedisore Komu | 17.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 460.00 |
| 20 | BABAJ PROJEC | Leje Mjedisore Komu | 24.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 330.00 |
| 21 | AZEM BEJTA | Leje Mjedisore Komu | 31.07.2024 | SKU4J3333333343Q | | | e liruar |
| 22 | SYLA GROUP | Leje Mjedisore Komu | 30.08.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 8,294.63 |
| 23 | SHALA COMPA | Leje Mjedisore Komu | 08.10.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 868.30 |
| 24 | DRENA SH.P.K. | Leje Mjedisore Komu | 27.09.2024 | SKU4J3333333343Q | | | 493.85 |
| | | | | | | | 37,923.01 € |

Drejtoria per Urbanizem dhe mbrojtje te ambientit raportin per numrin e lejeve mjedisore komunale deri me 13.11.2024

Drejtori
Idn.Driton Mulaj
Skenderaj, 13.11.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SKENDERAJT
OPŠTINA SKENDERAJ